

Maj 2026

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

MINISTRI I DREJTËSISË ZHVILLON TRYEZA NDËRINSTITUCIONALE NË QYTETE KRYESORE PËR VLERËSIMIN E PUNËS NË SHËRBIM TË QYTETARËVE



Lezhë

Ministri i Drejtësisë, zoti Toni Gogu, zhvilloi përgjatë muajit Maj disa tryeza ndërinstitutionale me degët e institucioneve të varësisë në qytetin e Shkodrës dhe Lezhës. Gjatë takimeve u diskutua mbi rezultatet konkrete të punës së këtyre institucioneve në shërbim të qytetarëve.



Shkodër


AKTIVITET NDËRGJEGJËSUES PRANË GJIMNAZIT “IBRAHIM RUGOVA”



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, zhvilluan ditën e sotme një aktivitet informues me studentët dhe stafin akademik të gjimnazit “Ibrahim Rugova”, me fokus njohjen dhe ndërgjegjësimin mbi institucionet e drejtësisë dhe rolin e tyre në shoqëri.

TRAJNIM 3 DITOR MBI LIGJIN NR. 111/ 2017 “PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI”

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, zhvilloi trajnimin 3 ditor mbi Ligjin Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Trajnimi u zhvillua në kuadër të forcimit të kapaciteteve profesionale të punonjësve të rinj të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.



AKTIVITET NDËRGJEGJËSUES PRANË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE KAMËZ



Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, zhvilluan ditën e sotme një aktivitet informues me studentët dhe stafin akademik të Shkollës së Mesme Profesionale Kamëz, me fokus njohjen dhe ndërgjegjësimin mbi institucionet e drejtësisë dhe rolin e tyre në shoqëri

AKTIVITETE TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

QSHNJP Korçë, në datën 07.05.2026, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë, zhvilloi aktivitet informues dhe ndërgjegjëses me nxënësit e gjimnazit “Petro Nini Luarasi” në Kolonjë, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shërbimin Social Kolonjë.



QSHNJP Korçë, në datën 07.05.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, zhvilloi aktivitet informues dhe ndërgjegjëses pranë Qendrës Ditore për të Moshuarit në Kolonjë, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shërbimin Social Kolonjë.

QSHNJP Korçë, në datën 15.05.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, mori pjesë në Forumin për Forcimin e Ndërveprimit Institucional në fushën e të drejtave ekonomike, sociale dhe të grupeve vulnerabël, me pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit dhe institucioneve vendore të Korçës dhe Pogradecit.



QSHNJP Korçë, në datën 25.05.2025, zhvilloi aktivitet “Street Law” me qytetarët për informimin mbi Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti, kategoritë përfituese, shërbimet e qendrës dhe vendndodhjen e saj.

QSHNJP Korçë, në datën 26.05.2026, mori pjesë në MKR për trajtimin e rastit të shtetasës M.K., duke evidentuar nevojën për ofrimin e ndihmës juridike dytësore për një çështje familjare të lidhur me dhunën në familje dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijëve.



QSHNJP Korçë, në datën 26.05.2026, në kuadër të promovimit të Ndhmës Juridike Falas, zhvilloi aktivitet informues në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe Përmbartimin Shtetëror Korçë pranë shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali”, mbi njohjen e ligjit dhe të drejtave të qytetarëve.

QSHNJP Kavajë, në datën 14.05.2026 mori pjesë në takimin koordinues të organizuar nga Zyra e Shërbimit të Provës në Shkollën 9-vjeçare “Rilindja” në Kavajë.





QSHNJP Kavajë, në datën 25.05.2026, në kuadër të rifillimit të aktivitetit dhe promovimit të shërbimeve, zhvilloi një aktivitet “Street Law” në qendër të qytetit të Kavajës



QSHNJP Kavajë, në datën 25.05.2026, zhvilloi një takim koordinues me Sektorin e Ndhmës Sociale pranë Bashkisë Kavajë, në kuadër të bashkëpunimit institucional.



QSHNJP Kukës, në datën 12.05.2026, në kuadër të analizës vjetore të performancës së institucioneve të drejtësisë, mori pjesë në takim me temë “Analiza vjetore e performancës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës”.



QSHNJP Dibër, në datën 07.05.2026, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional, zhvilloi një takim me Qendrën e Shërbimit të Provës, Qarku Dibër. QSHNJP Dibër, në datën 25.05.2026, në kuadër të planifikimit të aktiviteteve në bashkitë e vogla, zhvilloi aktivitet informues në Bashkinë Bulqizë, ku ofroi këshillim ligjor për qytetarët në sportelin “me një ndalesë”.



QSHNJP Kurbin, në datën 05.05.2026, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimit të mekanizmit të referimit të rasteve, organizoi një tryezë diskutimi në Bashkinë Kurbin me Kryetaren e Bashkisë znj. Majlinda Cara.



QSHNJP Kurbin, në datën 11.05.2026, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional dhe mekanizmit të referimit të rasteve, zhvilloi një tryezë diskutimi me Zv. Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, z. Arben Nika.



QSHNJP Kurbin, në datën 11.05.2026, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë, zhvilloi një takim me kryesekretarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.




QSHNJP Elbasan, më datë 04.05.2026, zhvilloi një aktivitet informues pranë ambienteve të Qendrës së Kujdesit Social, në kuadër të 1 Majit, Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve.



QSHNJP Elbasan, në kuadër të 15 Majit, Ditës Ndërkombëtare të Familjes, zhvilloi një aktivitet informues pranë ambienteve të Drejtorisë Rajonale të AKPA Elbasan.

QSHNJP Pukë, më datë 20.05.2026, mori pjesë në një aktivitet informues të organizuar nga Zyra e Punës Pukë.



QSHNJP Pukë, më datë 12.05.2026, zhvilloi takime informuese në terren për shpërndarjen e materialeve sensibilizuese mbi shërbimet e ndihmës juridike falas. Gjatë aktivitetit u shpërndanë fletë informuese në ambientet e Komisariatit të Policisë Pukë dhe u informuan punonjësit e Zyrës së Shërbimit për Qytetarët mbi shërbimet që ofron QSHNJP Pukë për qytetarët në nevojë.



QSHNJP Gjirokastrë, më datë 05.05.2026, zhvilloi një takim me përfaqësuesin e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Sarandë.



QSHNJP Gjirokastrë, më datë 11.05.2026, zhvilloi një aktivitet në bashkëpunim me Zyrën Përmbarimore Gjirokastrë dhe Shërbimin e Provës - Dega Territoriale Gjirokastrë.

QSHNJP Gjirokastrë, më datë 15.05.2026, mori pjesë në tryezën e organizuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, me temë “Analiza Vjetore e Punës - 2025”.



QSHNJP Gjirokastrë, më datë 29.05.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës - Dega Territoriale Gjirokastrë dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë, me temë “Drejtësi miqësore për fëmijë dhe të rritur në konflikt me ligjin”.



QSHNJP Përmet, më datë 07.05.2026, zhvilloi një takim informues “Street Law” në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.

QSHNJP Përmet, më datë 26.05.2026, mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar të zhvilluar në ambientet e Bashkisë Përmet, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shërbimit social, psikologes së bashkisë, shërbimit të provës, përmbarimit dhe shërbimit spitalor.



QSHNJP Fier, më datë 04.05.2026, mori pjesë në “Analizën e punës së kryer dhe performanca e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për vitin 2025”.

QSHNJP Fier, më datë 04.05.2026, mori pjesë në aktivitetin informues të zhvilluar nga Qendra “Epoka e Re”, NSPK, KMD dhe Policia e Shtetit në shkollën “Dino Ismaili” Levan.



QSHNJP Fier, më datë 08.05.2026, zhvilloi një takim informues në Bashkinë Lushnjë, në kuadër të informimit të qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe kategoritë përfituese.



QSHNJP Fier, më datë 11.05.2026, zhvilloi një takim informues në Bashkinë Mallakastër, në kuadër të prezantimit të shërbimeve ligjore falas dhe trajtimit të problematikave të qytetarëve.



QSHNJP Fier, më datë 13.05.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe programi SCPA, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore.



QSHNJP Fier, më datë 18.05.2026, mori pjesë në aktivitetin informues në shkollën jopublike “Alen” në Fier, në kuadër të parandalimit të krimit tek të rinjtë dhe rritjes së sigurisë në shkolla.



QSHNJP Fier, më datë 19.05.2026, mori pjesë në aktivitetin informues në gjimnazin “Perikli Ikonomi”, në kuadër të parandalimit të kriminalitetit tek të rinjtë dhe ndërgjegjësimin për sigurinë në shkolla.



QSHNJP Fier, më datë 20.05.2026, zhvilloi një takim informues në Qendrën Komunitare të Bashkisë Divjakë, në kuadër të prezantimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe forcimit të koordinimit me komunitetin.



QSHNJP Fier, më datë 25.05.2026, mori pjesë në aktivitetin informues në një shkollë jopublike “Dertliu”, në kuadër të ndërgjegjësimit për parandalimin e krimit tek të rinjtë dhe sigurisë në shkolla.



QSHNJP Fier, më datë 22.05.2026, mori pjesë në panairin e profesioneve pranë Shkollës Profesionale “Rakip Kryeziu” Fier, në kuadër të informimit të të rinjve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe aksesin në drejtësi.



QSHNJP Fier, më datë 28.05.2026, mori pjesë në forumin “Drejtësia për të miturit dhe roli i të rinjve në rritjen e sigurisë në shkolla”, në kuadër të forcimit të mbrojtjes ligjore të të miturve dhe garantimit të ndihmës juridike falas sipas ligjit nr. 111/2017.



QSHNJP Berat, më datë 15.05.2026, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Drejtoria e Turizmit e Bashkisë Berat dhe Shkolla 9-vjeçare “Ylli i Mëngjesit”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes.



QSHNJP Vlorë, më datë 10.05.2026, zhvilloi aktivitet informues në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë.

në Universitetin

QSHNJP Vlorë, më datë 15.05.2026, zhvilloi aktivitet informues pranë Konviktit të Vajzave, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes.



QSHNJP Vlorë, më datë 22.05.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra “Vatra”, me temë “Forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional në mbrojtjen e viktimave të dhunës bazuar në legjislacionin e përditësuar dhe qasjen me në qendër viktimën”.

QSHNJP Vlorë, më datë 29.05.2026, mori pjesë në aktivitetin ndërgjegjësues të zhvilluar në Shkollën “Internacional” në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, me temë “Respektimin e ligjit dhe shmangien e sjelljeve me risk”.



QSHNJP Lezhë, më datë 05.05.2026, mori pjesë në tryezën ndërinstytucionale të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN), në kuadër të mbrojtjes emergjente të rasteve të fëmijëve.

QSHNJP Lezhë, më datë 15.05.2026, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Lezhë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes, ku u organizua edhe panairi i shërbimeve të dedikuara për familjen.



QSHNJP Durrës, më datë 07.05.2026, zhvilloi aktivitet informues pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës në kuadër të “Javës së Drejtësisë”.


QSHNJP Durrës, më datë 11.05.2026, zhvilloi një takim pune në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe përfaqësues të Zyrës së Gjendjes Civile, Shërbimit Social, Shërbimit Përmbarimor, Qendrës Komunitare “Fuqizojmë Komunitetin” dhe strukturave të Bashkisë Durrës.



QSHNJP Durrës, më datë 15.05.2026, zhvilloi një aktivitet informues pranë Njesisë Administrative Sukth në kuadër të kalendarit të takimeve me bashkitë e vogla të Qarkut Durrës.



QSHNJP Durrës, më datë 15.05.2026, zhvilloi gjithashtu një aktivitet sensibilizues “Street Law” në qytetet Sukth dhe Durrës, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes.





QSHNJP Durrës, më datë 20.05.2026, mori pjesë në aktivitetin informues dhe sensibilizues të zhvilluar në shkollën “Olsi Lasko” në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe Zyrën Përmbartimore Vendore Durrës.



QSHNJP Durrës, më datë 28.05.2026, realizoi një podcast informues me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas.



QSHNJP Tiranë, më datë 07.05.2026, zhvilloi një tryezë ndërinstitucionale me përfaqësues të pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe zbatimit të Ligjit nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”.

QSHNJP Tiranë, më datë 11.05.2026, zhvilloi një aktivitet informues me studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë dhe promovimit të aksesit në drejtësi përmes ndihmës juridike falas.



QSHNJP Tiranë, më datë 15.05.2026, zhvilloi një aktivitet informues me aktivistë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të IRCA Albania, në kuadër të Ditës Botërore të Familjes dhe ndërgjegjësimit mbi të drejtat ligjore të familjeve dhe kategorive në nevojë.



QSHNJP Tiranë, më datë 19.05.2026, mori pjesë në takime informuese të zhvilluara në Gjimnazin “Qemal Stafa”, në kuadër të informimit të të rinjve mbi të drejtat ligjore, ndihmën juridike falas dhe institucionet e sistemit të drejtësisë.



QSHNJP Tiranë, më datë 29.05.2026, mori pjesë në një takim informues në Shkollën 9-vjeçare “Kongresi i Lushnjës”, në kuadër të edukimit ligjor të të rinjve dhe promovimit të mekanizmave të mbështetjes juridike dhe sociale për të miturit.



QSHNJP Shkodër, më datë 18.05.2026, organizoi një street law informues pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Familjes dhe ndërgjegjësimit mbi ndihmën juridike falas dhe mbrojtjen e të drejtave të familjes.



QSHNJP Shkodër, më datë 08.05.2026, organizoi një street law informues pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Bibliotekës Universitare dhe Katedrales së Shën Shtjefnit, në kuadër të Ditës Kombëtare të Drejtësisë dhe promovimit të aksesit në drejtësi përmes ndihmës juridike falas.



NJOFTIM!!!!

Ju njoftojmë se QSHNJP Shkodër ka ndryshuar vendndodhjen, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më të aksesueshëm dhe efikas për qytetarët. Në ambientet e reja, qytetarët do të vijojnë të marrin asistencë juridike falas, këshillim ligjor dhe mbështetje për akses në drejtësi.

Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, pranë Bashkisë Shkodër.

